




05/2026

MONITORUESI I LEGJISLATURËS SË X-TË

05/2026
MAJ, 2026



Autorë: Naim Jakaj dhe Melos Kolshi

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj, Betim Musliu dhe Qemajl Marmullakaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Rockefeller Brothers Fund (RBF).

Implementuar nga:



Mbështetur nga:



RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Maj, 2026
Prishtinë, Republika e Kosovës

LISTA E SHKURTESAVE

KRK	Kuvendi i Republikës së Kosovës
ZKM	Zyra e Kryeministrit të Kosovës
POKP	Platforma Online e Konsultimeve Publike
RrPK	Rregullorja e Punës së Kuvendit
PL 2022	Programi Legjislativ për vitin 2022
GP LV	Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!
GP PDK	Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës
GP LDK	Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës
GP AAK	Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës
GP LS	Grupi Parlamentar i Listës Serbe
GP MULTI ETNIK	Grupi Parlamentar i deputetëve nga komunitetet jo shumicë
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
GJK	Gjykata Kushtetuese
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit
KiE	Këshilli i Evropës
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
ME	Ministria e Ekonomisë
MBPZhr	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Sfond: Kriza institucionale gjatë vitit 2025 dhe rruga drejt zgjedhjeve të vitit 2026

Kriza institucionale në Kuvendin e Kosovës gjatë vitit 2025 lidhej drejtpërdrejt me procesin e zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit, i cili u shndërrua në një ngërç politik dhe procedural që zgjati për një periudhë të konsiderueshme. Mospajtimet ndërmjet subjekteve politike mbi mënyrën e votimit dhe interpretimin e rregullave parlamentare bënë që Kuvendi të mos arrijë të konstituohet në kohë, duke bllokuar funksionimin normal të institucionit dhe të gjithë shtetit të Kosovës.

Në thelb të kësaj krize qëndronte ndryshimi i mënyrës së votimit për Kryetarin e Kuvendit. Praktika e deriatëhershme ishte votimi i hapur, ndërsa partia e parë që kishte dalë nga zgjedhjet, Lëvizja VETËVENDOSJE, tentoi që të kalohet me votim të fshehtë pa një bazë të qartë procedurale dhe pa konsensus politik. Ky veprim u kundërshtua nga partitë opozitare, duke e thelluar krizën dhe duke e zhvendosur çështjen në nivel kushtetues.

Për pasojë, çështja u dërgua në Gjykatën Kushtetuese, e cila sqaroi se procedurat parlamentare duhet të jenë të qarta, të parashikueshme dhe të pandryshueshme në mënyrë ad hoc gjatë procesit të votimit. Vendimi i saj synoi të rikthente rendin procedural dhe të parandalonte manipulimin e rregullave në funksion të rezultateve politike.

Pas këtij zhvillimi, Kuvendi votoi në mënyrë të hapur për Kryetar të Kuvendit, deputetin Dimal Basha dhe nënkryetarët e Kuvendit, me cc'rast Kuvendi i Kosovës u konsiderua i konstituar dhe Presidentja e Republikës i dha mandatin për formimin e Qeverisë kandidatit për Kryeministër, Albin Kurti. Megjithatë, ai nuk arriti të sigurojë votat e nevojshme në Kuvend. Në përputhje me procedurat kushtetuese, e njëjta parti, Lëvizja Vetëvendosje, mori edhe një mundësi të dytë për të propozuar një mandatar tjetër, këtë herë Glauk Konjufcën, i cili po ashtu nuk arriti të sigurojë shumicën parlamentare për formimin e Qeverisë.

Si rezultat i dështimit të dy përpjekjeve për formimin e Qeverisë, vendi u drejtua drejt zgjedhjeve të reja parlamentare, të cilat u mbajtën më 28 dhjetor 2025. Nga këto zgjedhje u certifikuan 120 deputetë në Legjislaturën X të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Shumicën parlamentare e përbën Lëvizja Vetëvendosje me 57 deputetë (51.1% të votave), e ndjekur nga Partia Demokratike e Kosovës me 22 deputetë (20.19%) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës me 15 deputetë (13.24%). Lista Serbe përfaqësohet me 9 deputetë, ndërsa Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka 6 deputetë. Kjo përbërje reflekton një Kuvend me dominim të një subjekti të vetëm, por që për vendimmarrje të rëndësishme kërkon bashkëpunim ndërmjet partive politike.

Përmbledhje: Legjislatura e X-të, 11 shkurt 2026 - 28 prill 2026

Legjislatura e X-të e Kuvendit të Kosovës nisi me një ritëm të shpejtë të vendimmarrjes, por që në thelb reflektoi më shumë formalitet sesa funksionim të plotë demokratik. Në një periudhë relativisht të shkurtër kohore, Kuvendi zhvilloi një numër të madh seancash, por cilësia e debatit dhe respektimi i standardeve parlamentare shpesh mbetën në plan të dytë.

Procesi i formimit të Qeverisë u karakterizua nga mungesë e theksuar e transparencës. Deputetët dhe opinioni publik nuk patën asnjë informacion paraprak për përbërjen e kabinetit, ndërsa zgjerimi i tij u bë pa arsyetim të qartë. Në vend të një programi të plotë qeverisës, u paraqit një ekspozitë e shkurtër, duke kufizuar seriozisht mundësinë për debat dhe llogaridhënie në një moment kyç për vendin.

Në të njëjtën kohë, opozita dështoi të luajë rolin e saj. Në seancën për votimin e Qeverisë, ajo u mjaftua me prezencë minimale dhe deklarime simbolike, duke lënë pa trajtuar çështje të rëndësishme që prekin drejtpërdrejt jetën e qytetarëve. Kjo krijoi një hendek të dukshëm në funksionin mbikëqyrës të Kuvendit.

Në planin legjislativ, janë evidentuar me dhjetëra tentativa të përsëritura për shmangie të procedurave të rregullta nga ana e shumicës parlamentare. Projektligje me rëndësi të lartë, si ai për Byronë dhe për buxhetin, janë tentuar të procedohen me shpejtësi, madje edhe kur nuk ekzistonte ndonjë urgjencë reale. Edhe kur shmangia nuk u miratua, procesi vazhdoi me nguti, duke e kthyer konsultimin publik në formalitet.

Një pjesë e rëndësishme e proceseve parlamentare u zhvilluan jashtë logjikës së planifikimit të rregullt. Mbi 40% e seancave ishin të jashtëzakonshme, kryesisht të thirrura nga shumica parlamentare, duke treguar kontroll të fortë mbi agjendën dhe orientim drejt vendimmarrjes ad hoc, në vend të një procesi të strukturuar dhe të parashikueshëm.

Procesi për zgjedhjen e Presidentit ishte një nga episodet më problematike të kësaj legjislature. Ai u zhvillua pa marrëveshje politike, pa transparencë dhe në kundërshtim me rregullat kushtetuese. Seancat u thirrën edhe pse mungonin votat e nevojshme, ndërsa në disa raste u zhvilluan pa kuorumin e kërkuar, duke cenuar seriozisht ligjshmërinë dhe legjitimitetin e procesit. Dështimi për gjetjen e një zgjidhjeje në këtë seancë rezultoi me Kuvend të shpërndarë.

Në të njëjtën kohë, tentativa për të proceduar me nguti amendamente kushtetuese për zgjedhjen e Presidentit në mënyrë direkte, pa debat të gjerë politik dhe shoqëror, tregoi një qasje problematike ndaj ndryshimeve me rëndësi themelore për rendin kushtetues. Këto procese u ndalën për shkak të mungesës së votave, por reflektuan mungesë të qartë të përgatitjes dhe konsensusit.

Në funksionin mbikëqyrës, Kuvendi nuk arriti të jetë efektiv. Pyetjet parlamentare u shtynë nga një seancë në tjetrën, shpesh për shkak të mungesës së ministrave ose vetë deputetëve, duke e zbehur rolin e tyre si mekanizëm për llogaridhënie të drejtpërdrejtë.

Analiza e aktivitetit të deputetëve tregon një tjetër problem strukturor. Debati parlamentar është përqendruar kryesisht në ekonomi dhe procedurë, ndërsa tema të rëndësishme si integrimet evropiane, të drejtat e komuniteteve, mjedisi apo dialogu Kosovë-Serbi janë lënë pothuajse jashtë vëmendjes. Për më tepër, 26 deputetë nuk kanë mbajtur asnjë deklaratë, duke reflektuar një nivel shqetësues të mosangazhimit.

Megjithatë, në këtë legjislaturë ka pasur edhe raste të korigjimit të qasjeve të gabuara, si trajtimi i nismës për Projektligjin për Parandalimin e Vetëvrasjes, ku Kuvendi u kthye te roli i tij pas insistimit publik. Por fakti që këto korigjime erdhën vetëm pas presionit tregon mungesë të një qasjeje të qëndrueshme institucionale.

Në tërësi, Legjislatura e X-të paraqet një Kuvend që funksionon, por jo gjithmonë në përputhje me standardet që kërkon një demokraci funksionale: me vendimmarrje të shpejtë, por jo gjithmonë të menduar; me debat, por jo gjithmonë përmbajtësor; dhe me përgjegjësi, por shpesh të shpërndarë dhe të paqartë.

Instituti i Kosovës për Drejtësi ka ndjekur punën e Kuvendit gjatë kësaj legjislature, ndërsa rezultatet e monitorimit të detajuar do të paraqiten më poshtë:

Zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit përmes votimit në pako

Në praktikën e mëhershme parlamentare, nënkryetarët e Kuvendit janë votuar në dy faza: tre nënkryetarët nga komuniteti shumicë dhe dy nga komunitetet joshumicë janë votuar ndaras. Në Legjislaturën IX, insistimi i Lëvizjes VETËVENDOSJE! për votim të ndarë për nënkryetarët nga komunitetet joshumicë ka çuar në zvarritje të procesit, përfshirë edhe rastin e zgjedhjes së nënkryetarit nga komuniteti serb. Kjo bëri që rasti të adresohet në Gjykatën Kushtetuese për tu vlerësuar.

Në bazë të Aktgjykimi KO265/25 i Gjykatës Kushtetuese, votimi në pako i nënkryetarëve nuk është i përcaktuar shprehimisht në Kushtetutë, por lejohet nëse ka dakordim ndërmjet grupeve parlamentare. Në këtë kuadër, në Legjislaturën X, zgjedhja e pesë nënkryetarëve është realizuar përmes votimit në pako, bazuar në dakordimin e arritur ndërmjet subjekteve politike para seancës konstituive.[1]

Rekomandim: Kuvendi i Kosovës duhet të zhvillojë një diskutim përmbajtësor lidhur me mënyrën e votimit të nënkryetarëve, duke shqyrtuar mundësitë për harmonizimin e praktikës parlamentare me Aktgjykimin KO265/25 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit, në mënyrë që të sigurohet qartësi dhe qëndrueshmëri në këtë proces, duke u siguruar që t'i menjanojë sfidat apo krizat që mund të ndodhin.

Propozimi i kabinetit qeveritar pa transparencë dhe pa arsyetim paraprak

Formimi i Qeverisë së Kosovës është karakterizuar nga mungesa e transparencës në procesin e propozimit të kabinetit qeveritar. Deputetët e Kuvendit dhe opinionin publik nuk kanë pasur njohuri paraprake për përbërjen e kabinetit, përfshirë emrat e ministrave dhe strukturën e

[1] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. "Aktgjykim në rastin nr. KO265/25." Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. 08.10.2025. Link: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=111235> (Qasur për herë të fundit më: 06.05.2026).

ministrive, deri në momentin kur Kryeministri Albin Kurti e ka paraqitur atë në seancën për votim.[2]

Kabineti i ri qeveritar përbëhet nga tre zëvendëskryeministra dhe 19 ministri, duke shënuar rritje të konsiderueshme krahasuar me mandatin e kaluar. Megjithatë, ky ristrukturim nuk është shoqëruar me arsyetim publik, analizë funksionale, vlerësim dhe alokime financiare që do të dëshmonte nevojën për zgjerimin e strukturës qeveritare, duke mos përfshirë as profilin e detajuar e ministrave dhe lidhjen e tyre profesionale me ministrinë që do t'i drejtojnë.

Mungesa e transparencës dhe debatit në Kuvend për çështjen e strukturës së kabinetit qeveritar ka kufizuar mundësinë e deputetëve për të ushtruar kontroll parlamentar të informuar mbi përbërjen dhe strukturën e Qeverisë, si dhe ka cenuar standardet e llogaridhënies dhe debatit publik për një vendim me rëndësi të lartë institucionale.

Rekomandim: Kryeministri dhe Kuvendi i Kosovës duhet të sigurojnë transparencë të plotë në procesin e formimit të Qeverisë, duke paraqitur paraprakisht përbërjen e kabinetit dhe arsyetimin për çdo ristrukturim, në mënyrë që të mundësohet debat i informuar dhe ushtrim efektiv i kontrollit parlamentar. Po ashtu, në këtë kuadër, Kryeministri duhet të prezantojë edhe përbërjen e kabinetit qeveritar, duke theksuar shkurtimisht profilin profesional të ministrave dhe lidhjen e tyre me dikasteret përkatëse që do të udhëheqin.

Mungesa e një programi të plotë qeverisës dhe paraqitja e ekspozes së kufizuar

Gjatë procesit të formimit të Qeverisë, në vend të një programi të plotë dhe të detajuar qeverisës që reflekton prioritetet e qeverisë dhe bazuar në të ristrukturimin e strukturës qeveritare, është paraqitur një ekspozë e shkurtër. Ekspozëja e paraqitur nuk ka ofruar informacion të mjaftueshëm për prioritetet, objektivat dhe mënyrën e zbatimit të politikave publike, dhe nuk ka reflektuar në mënyrë të qartë strukturën e zgjeruar të Qeverisë dhe ndarjen e përgjegjësive ndërmjet ministrive[3]

Mungesa e një programi të detajuar ka kufizuar mundësinë e deputetëve për të vlerësuar në mënyrë të informuar orientimin politik dhe prioritetet e Qeverisë, si dhe ka reduktuar nivelin e llogaridhënies ndaj publikut në një moment kyç të formimit të ekzekutivit.

Rekomandim: Qeveria e Kosovës duhet të paraqesë një program të plotë, të detajuar dhe të qartë qeverisës gjatë procesit të votimit, i cili reflekton strukturën e saj dhe mundëson debat të informuar dhe llogaridhënie para Kuvendit dhe qytetarëve.

Mungesë serioze e angazhimit të opozitës gjatë seancës për votimin e Qeverisë

Gjatë seancës për votimin e Qeverisë, opozita tregoi mungesë serioze të angazhimit në debat parlamentar. Përkundër faktit se sipas Rregullores së Kuvendit të Kosovës çdo deputet ka të

[2] Seanca plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 11 shkurt 2026, ora 20:00. Link: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2026_02_11_ts_Seanca,ora20.00_ALPFPwgHND.pdf. (qasur për herë të fundit më: 06 maj 2026).

[3] Seanca plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 11 shkurt 2026, ora 20:00. Link: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2026_02_11_ts_Seanca,ora20.00_ALPFPwgHND.pdf. (qasur për herë të fundit më: 06 maj 2026).

drejtë të marrë fjalën deri në 10 minuta,[4] nga grupet parlamentare opozitare kanë folur vetëm përfaqësuesit kryesorë: Bedri Hamza nga PDK (22 deputetë), Lumir Abdixhiku nga LDK (15 deputetë), Besnik Tahiri nga AAK (6 deputetë) dhe Artan Asllani nga grupi parlamentar multietnik.[5]

Kjo qasje minimale ka bërë që seanca të kalojë pa debat real parlamentar. Një vit i karakterizuar nga kriza energjetike, rritja e çmimeve të derivateve dhe produkteve ushqimore, si dhe probleme të tjera me ndikim të drejtpërdrejtë në qytetarë, nuk është trajtuar në mënyrë përmbajtësore dhe nuk janë kërkuar sqarime nga kandidati për Kryeministër.

Në një moment kyç si formimi i Qeverisë, opozita është mjaftuar me prezencë formale, duke mos ushtruar rolin e saj kushtetues për debat dhe llogaridhënie.

Rekomandim: Secila opozitë parlamentare duhet të ushtrojë në mënyrë aktive dhe substanciale rolin e saj mbikëqyrës, duke shfrytëzuar hapësirën parlamentare për debat përmbajtësor dhe kërkim të llogaridhënies nga Qeveria, veçanërisht në momente kyçe si votimi i saj.

Disa dështime të legjislaturës IX, korrigjohen nga legjislatura X

Një numër i konsiderueshëm i çështjeve me rëndësi të lartë publike dhe financiare, të cilat është dashur të trajtoheshin gjatë Legjislaturës IX, nuk janë miratuar me kohë dhe janë bartur për shqyrtim në Legjislaturën X. Këto përfshijnë ratifikimin e marrëveshjes me Bashkimin Evropian për Planin e Rritjes në vlerë prej mbi 882 milionë euro, marrëveshjen me Bankën Botërore në vlerë prej 90 milionë euro, si dhe vendime të tjera të rëndësishme që lidhen me ndarjet buxhetore dhe financimin e institucioneve publike.

Mosmiratimi i tyre në legjislaturën paraprake ka krijuar rrezik për pasoja financiare dhe institucionale, si dhe ka reflektuar mungesë të prioritizimit të çështjeve me interes të lartë publik.

Megjithatë, në fillim të Legjislaturës X, Kuvendi ka vepruar në mënyrë efikase duke i trajtuar dhe miratuar këto çështje, duke shmangur kështu pasoja të mëtejshme për funksionimin e institucioneve dhe përfitimet financiare për vendin.

Rekomandim: Kuvendi i Kosovës duhet të sigurojë trajtim me kohë të çështjeve me rëndësi të lartë publike dhe financiare brenda mandatit të secilës legjislaturë, në mënyrë që të shmanget bartja e tyre dhe të minimizohen rreziqet që mund të prodhohen për interesin publik dhe funksionimin institucional.

[4] Neni 60.1. Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës. 9 gusht 2022.

[5] Seanca e Jashtëzakonshme e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 11 shkurt 2026, ora 20:00. Link: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2026_02_11_ts_Seanca,ora20.00_ALPFPwgHND.pdf (qasur më: 6 maj 2026).

Propozimi i panevojshëm për shmangien e procedurave për Projektligjin për ndarjet buxhetore 2026

Gjatë shqyrtimit të Projektligjit për ndarjet buxhetore për vitin 2026, shumica parlamentare ka propozuar shmangien nga procedurat e rregullta parlamentare, përkundër faktit se nuk ka ekzistuar ndonjë nevojë reale për një trajtim të tillë të përshpejtuar.[6]

Një ditë më parë, Kuvendi kishte miratuar vendimin për autorizimin e zgjatjes së zbatimit të Ligjit për ndarjet buxhetore të vitit paraparak edhe për muajin mars 2026, duke eliminuar çdo rrezik për ndërprerje të financimit publik. Në këto rrethana, propozimi për shmangie të procedurave nuk ka qenë i arsyetuar.[7]

Megjithëse propozimi është votuar nga deputetët e shumicës parlamentare, pas insistimit për debat, shqyrtimi i këtij projektligji është shtyrë për disa ditë, duke mundësuar kohë shtesë për përgatitje dhe trajtim më të kujdesshëm të këtij ligji me rëndësi të veçantë.

Rekomandim: Projektligji për ndarjet buxhetore duhet të trajtohet përmes procedurave të rregullta parlamentare, përveç rasteve të gjendjes së jashtëzakonshme, duke iu nënshtruar debatit të plotë parlamentar dhe konsultimit publik, në mënyrë që të garantohet transparencë dhe cilësi në vendimmarrje.

Dështimi i miratimit të amendamenteve kushtetuese për vetting dhe mungesa e përpjekjeve për konsensus

Në vitin 2024 (Legjislatura e VIII-të), Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur t'i miratojë amendamentet kushtetuese për procesin e vettingut në sistemin e drejtësisë, për shkak të mungesës së votave të mjaftueshme nga deputetët e komuniteteve joshumicë.[1] Në seancën e datës 15 shkurt nuk është siguruar mbështetja e kërkuar prej dy të tretave (2/3) të deputetëve të komuniteteve, përfshirë mungesën e pjesëmarrjes së deputetëve të Listës Serbe.

Përkundër rëndësisë së kësaj reforme për sistemin e drejtësisë, nuk janë evidentuar përpjekje serioze për të siguruar konsensus politik dhe për të komunikuar me deputetët e komuniteteve joshumicë që vijnë nga serbët, me qëllim sigurimin e votave të nevojshme për miratimin e amendamenteve.

Edhe në Legjislaturën X, kjo çështje nuk është riadresuar dhe nuk është ndërmarrë ndonjë iniciativë për ta rikthyer në procedurë votimin e amendamenteve kushtetuese, duke lënë në vend një nga reformat kyçe të sistemit të drejtësisë.

Rekomandim: Qeveria dhe shumica parlamentare duhet të angazhohen në mënyrë aktive për ndërtimin e konsensusit politik për ndryshimet kushtetuese, veçanërisht përmes komunikimit dhe përfshirjes së deputetëve të komuniteteve joshumicë, në mënyrë që të sigurohet miratimi i reformave të rëndësishme për sistemin e drejtësisë.

[6] Seanca pleanare e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 13 shkurt 2026.

https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2026_02_13_ts_Seanca_CMdefcyAct.pdf. (qasur më: 6 maj 2026).

[7] Seanca e Jashtëzakonshme e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 27 prill 2026.

https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2026_04_25_ts_Seanca_qMxd2cyaSA.pdf. (qasur më: 6 maj 2026).

[8] Seancë e Veçantë e Kuvendit të Republikës së Kosovës. 15 shkurt 2026.

https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2024_02_15_ts_Seanca_ora10.00_WrunHy3aUW.pdf. (qasur më: 6 maj 2026).

Nga devijimi te korrighjimi i qasjes: rasti i Projektligjit për Parandalimin e Vetëvrasjes

Nisma për Projektligjin për Parandalimin e Vetëvrasjes, e iniciuar në vitin 2024 dhe i mbështetur nga 10,034 qytetarë dhe një koalicion organizatash, paraqet një shembull të qasjes problematike në trajtimin e nismave legjislative qytetare. Nismëtarët kishin kërkuar që projektligji të hartohet nga vetë Kuvendi, përmes deputetëve dhe komisionit përkatës, në bashkëpunim me iniciuesit. [9]

Megjithatë, Kryesia e Kuvendit në Legjislaturën VIII kishte vendosur që këtë çështje ta procedojë në seancë plenare me propozimin që projektligji të hartohet nga Qeveria, duke devijuar nga thelbi i nismës qytetare dhe roli i Kuvendit si institucion përfaqësues. Kjo qasje u kundërshtua nga nismëtarët, të cilët kërkuar që përgjegjësia për hartimin e projektligjit të mbetet te Kuvendi. Pas reagimeve dhe insistimit të vazhdueshëm të iniciuesve të nismës legjislative, çështja u rikthye në Kryesi dhe u la për trajtim në Legjislaturën X.

Në këtë legjislaturë, Kuvendi ka ndërmarrë një qasje më ndryshe nga legjislatura e kaluar, duke formuar Komisionin Ad-Hoc për hartimin e projektligjit dhe duke përfshirë nismëtarët në këtë proces. Ky zhvillim përbën një korrighjim të qasjes së mëhershme dhe rikthim te parimet e trajtimit të nismave legjislative qytetare. Megjithatë, fakti që ky korrighjim ka ardhur vetëm pas reagimeve publike dhe insistimit të vazhdueshëm tregon për mungesë të një qasjeje të qëndrueshme dhe të parashikueshme institucionale në trajtimin e nismave të tilla.

Rekomandim: Legjislatura e XI e Kuvendit të Kosovës duhet të trajtojë me urgjencë dhe prioritet Projektligjin për Parandalimin e Vetëvrasjes, duke përmbyllur procesin e hartimit dhe miratimit të tij në përputhje me kërkesat e nismës qytetare. Në të njëjtën kohë, Kuvendi duhet të sigurojë një qasje të qëndrueshme dhe të parashikueshme në trajtimin e nismave legjislative qytetare, duke respektuar rolin e tij kushtetues dhe duke shmangur delegimin e përgjegjësiave tek institucionet e tjera.

Tentativa për procedimin e përshpejtuar të amendamenteve kushtetuese për zgjedhjen e Presidentit

Më 5 mars 2026, Presidentja Vjosa Osmani dërgoi në Kuvendin e Kosovës propozimin për amendamente kushtetuese që synojnë ndryshimin e mënyrës së zgjedhjes së Presidentit, nga zgjedhja në Kuvend në zgjedhje të drejtpërdrejtë nga qytetarët. Për shqyrtimin e tyre është thirrur një seancë e jashtëzakonshme.[10]

Amendamentet në fjalë janë hartuar në vitin 2014 dhe janë vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës në atë kohë. Megjithatë, pavarësisht këtij fakti, procedimi i amendamenteve kushtetuese nuk mund të trajtohet si proces i zakonshëm apo të zhvillohet me nguti.[11]

[9] Betimi për Drejtësi. "Dorëzohet në Kuvend peticioni për projektligjin për parandalimin e vetëvrasjes." 10 shtator 2024. <https://betimiperdrejtesi.com/dorezohet-ne-kuvend-peticioni-per-projektligjin-per-parandalimin-e-vetevrasjes/>. (qasur më: 6 maj 2026).

[10] Seanca e Jashtëzakonshme Kuvendit të Republikës së Kosovës. 5 mars 2026. Ora 20:00. https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2026_03_05_ts_Seanca_ora20.00_qvnftkpt6a.pdf. (qasur për herë të fundit më: 6 maj 2026).

[11] Rastet KO29/12 dhe KO48/12. "Aktgjykim – Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012." Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, 2012. Link: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ko_29_12_shq.pdf. (qasur për herë të fundit më: 06 maj 2026).

Ndryshimet kushtetuese, veçanërisht ato që prekin çështje substanciale si mënyra e zgjedhjes së Presidentit, përbëjnë ndërhyrje të thellë në rendin kushtetues dhe kërkojnë trajtim të zgjeruar institucional dhe shoqëror. Tentativa për procedimin e tyre në një afat të shkurtër, pa koordinim politik dhe pa debat të gjerë publik nuk është në përputhje me standardet demokratike të një procesi të tillë.

Në seancën e 5 marsit, amendamentet kushtetuese nuk kanë kaluar në fazën e votimit, pasi nuk janë plotësuar kushtet të parapara me kushtetë për vazhdimin e procedurës. Edhe pse në sallë kanë qenë të pranishëm 93 deputetë, përfshirë 9 deputetë nga komunitetet joshumicë, kjo nuk ka qenë e mjaftueshme për të përmbushur kriterin e kërkuar prej së paku 2/3 të deputetëve nga komunitetet joshumicë, respektivisht minimumi 14 deputetë. Për pasojë, procesi nuk ka mundur të vazhdojë me votimin e amendamenteve kushtetuese.

Rekomandim: Amendamentet kushtetuese duhet të trajtohen përmes një procesi të zgjeruar dhe gjithëpërfshirës, që përfshin debat të gjerë parlamentar dhe shoqëror mbi përmbajtjen dhe pasojat e tyre dhe që ndërlidhen me situatën aktuale politike. Institucionet propozuese duhet të sigurojnë transparencë, kohë të mjaftueshme për shqyrtim dhe përfshirje të akterëve relevantë, në mënyrë që çdo ndryshim kushtetues të reflektojë konsensus të gjerë dhe të jetë rezultat i një procesi të mirëfilltë demokratik.

Thirrja e seancës për zgjedhjen e Presidentit pa marrëveshje politike dhe pa transparencë

Më 5 mars 2026 është thirrur seanca e jashtëzakonshme për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës[12], ndonëse ishte e qartë paraprakisht se nuk ekzistonte shumica e nevojshme për votim. Për zgjedhjen e Presidentit kërkohen së paku 80 vota në dy raundet e para dhe 61 vota në raundin e tretë, i cili mund të arrihet vetëm pas konsumimit të dy raundeve të para.

Lëvizja Vetëvendosje, si shumicë parlamentare, dispononte vetëm 64 vota, duke e bërë të pamundur sigurimin e shumicës së nevojshme pa mbështetjen e partive të tjera politike. Përkundër kësaj, seanca është thirrur pa arritur më parë një marrëveshje politike.

Kryeministri Albin Kurti ka zhvilluar takime me Bedri Hamzën e PDK dhe Lumir Abdixhikun e LDK, mirëpo pa rezultat konkret. Për më tepër, këto takime janë zhvilluar pa asnjë transparencë publike, pasi asnjëra nga palët nuk ka bërë të ditur se çfarë është diskutuar, nëse është negociuar ndonjë marrëveshje politike, apo nëse janë trajtuar çështje që lidhen me përfshirjen e partive opozitare në qeverisje.

Deri në përfundimin e afatit kushtetues për përzgjedhjen e Presidentit nga Kuvendi, liderët politikë dhe përfaqësuesit e partive kanë dhënë versione të ndryshme lidhur me diskutimet e zhvilluara apo mungesën e tyre.

Kjo situatë reflekton mungesë të përpjekjeve serioze për ndërtimin e konsensusit politik dhe një qasje formale ndaj një procesi që kërkon bashkëpunim të gjerë ndërpartiak.

[12] Seanca e Jashtëzakonshme e Kuvendit të Republikës së Kosovës. 5 mars 2026, ora 22:00. Link: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2026_03_05_ts_Seanca_ora22.00_M2JJvSqVKD.pdf. (qasur për herë të fundit më: 03 maj 2026).

Rekomandim: Seancat për zgjedhjen e Presidentit nuk duhet të thirren pa siguruar paraprakisht një marrëveshje politike për shumicën e nevojshme. Partitë politike duhet të angazhohen në dialog të mirëfilltë dhe transparent, duke ndërtuar konsensus mbi bazë të mirëbesimit, në mënyrë që procesi të jetë funksional dhe i suksesshëm.

Zhvillimi i procesit për zgjedhjen e Presidentit në kundërshtim me rendin kushtetues

Lëvizja Vetëvendosje në zgjedhjet e fundit të jashtëzakonshme ka siguruar mbi 50% të votave, të mjaftueshme për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit dhe formimin e Qeverisë, por jo edhe për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, për të cilin kërkohen së paku 80 vota të deputetëve. Në këtë drejtim, kryetari i kësaj partie, Albin Kurti, ka zhvilluar takime me Bedri Hamza dhe Lumir Abdixhiku, por pa arritur ndonjë marrëveshje politike. Në vijim, janë propozuar si kandidatë për President Glauk Konjufca dhe Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, mirëpo në seancën e 5 marsit 2026 nuk u zhvillua rëndi i parë i votimit për shkak të mungesës së kuorumit, pasi deputetët e PDK-së, LDK-së, AAK-së dhe Listës Serbe nuk kanë marrë pjesë në seancë.[13]

Procesi për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës është karakterizuar nga shkelje të rënda kushtetuese dhe procedurale. Seanca për zgjedhjen e Presidentit është zhvilluar pa kuorumin e nevojshëm, pasi në sallë kanë qenë vetëm 64 deputetë, ndonëse Kushtetuta kërkon praninë e së paku 80 deputetëve për zhvillimin e procedurës së votimit.[14]

Po ashtu, janë evidentuar shkelje procedurale në thirrjen e mbledhjes së Komisionit për Legjislacion vetëm pak minuta para mbajtjes së saj, duke pamundësuar pjesëmarrjen efektive të deputetëve dhe duke cenuar transparencën e procesit.

Lëvizja Vetëvendosje kishte bërë edhe një përpjekje tjetër për zgjedhjen e Presidentit të Kosovës, mirëpo edhe ajo kandidaturë nuk kishte rezultuar me sukses për shkak të mungesës së kuorumit dhe bojkotit të partive opozitare në Kuvend. Më pas, në një tentim tjetër, LVV propozoi Feride Rushitin dhe Hatixhe Hoxhën si kandidate për presidente, duke kërkuar mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme më 27 prill 2026. Edhe kjo seancë dështoi të prodhonte zgjedhjen e presidentit, pasi opozita nuk mori pjesë në votim, për arsye se mungonte një marrëveshje mes LVV dhe opozitës, kështu duke pamundësuar sigurimin e kuorumit të nevojshëm kushtetues. Në votimin e zhvilluar, Feride Rushiti mori 63 vota, ndërsa Hatixhe Hoxha nuk mori asnjë votë.[15] Në të njëjtën kohë, procesi është shoqëruar me keqinterpretim të rregullave kushtetuese lidhur me nominimin e kandidatëve dhe nënshkrimet e deputetëve. Përkundër faktit se kandidaturat fillestare kishin përmbushur kriteret kushtetuese, tërheqja e tyre nuk rikthen vlefshmërinë e nënshkrimeve për kandidatë të rinj, pasi ato konsiderohen të konsumuara në momentin e dorëzimit, sipas praktikës së Gjykatës Kushtetuese e Kosovës.

[13] Seanca plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës. 5 mars 2026, ora 22:00. Link: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2026_03_05_ts_Seanca_ora22.00_M2JJvSqVKD.pdf. (qasur për herë të fundit më: 06 maj 2026)

[14] Neni 86, paragrafi 5, Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 09 prill 2008

[15] Kuvendi i Republikës së Kosovës. "Seanca plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës, 27 prill 2026, ora 17:00." Link: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2026_04_27_ts_Seanca_ora17.00_X826KsqD53.pdf. Qasur për herë të fundit më: 04.05.2026.

Rekomandim: Partitë politike, veçanërisht subjekti me numrin më të madh të votave, duhet të marrin përgjegjësi për të siguruar bashkëpunim ndërpartiak dhe për të arritur konsensus rreth një kandidati unifikues për President. Në të njëjtën kohë, Kuvendi i Kosovës duhet të zhvillojë procedurën për zgjedhjen e Presidentit në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe rregullat parlamentare, në mënyrë që të garantohet ligjshmëria dhe legjitimiteti i procesit.

Tallja me zgjedhjen e Presidentit, mesazhi “karate” në seancë

Gjatë seancës së jashtëzakonshme për zgjedhjen e Presidentit, një deputet i Lëvizjes Vetëvendosje, deputeti Naim Bardiqi, është fotografuar duke dërguar një mesazh në telefon, në të cilin përdor shprehjen “Po e zgjedhim ‘karate’, pastaj të shohim çfarë thotë Kushtetusia”.

Ky komunikim, i bërë gjatë një prej proceseve më të rëndësishme kushtetuese në vend, reflekton një qasje joserioze dhe minimizon rëndësinë e procedurës për zgjedhjen e Presidentit. Referimi në mënyrë ironike ndaj procesit dhe implicit ndaj rolit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës krijon perceptim negativ për mënyrën se si deputetët e trajtojnë përgjegjësitë e tyre institucionale.

Edhe pse deputeti Bardiqi më pas ka kërkuar falje dhe e ka cilësuar mesazhin si sarkazëm, dhe ka tentuar të kërkojë përgjegjësi për shkelje të privatësisë, një sjellje e tillë në një moment kaq të rëndësishëm e dëmton besimin e publikut në seriozitetin e procesit parlamentar dhe në integritetin e vendimmarrjes.[16]

Në këtë kontekst, deklaratat dhe komunikimet e tilla nuk duhet parë vetëm si raste individuale apo të izoluar, por si reflektim i një qasjeje më të gjerë ndaj procesit të përzgjedhjes së Presidentit. Pavarësisht faktit që deputetët janë të vetëdijshëm për kërkesat kushtetuese dhe procedurat që duhet të ndiqen për të siguruar një proces të rregullt dhe legjitim, shpesh vërehet një tendencë për të relativizuar këto obligime, duke lënë hapësirë që çështje të tilla të adresohen më pas nga Gjykata Kushtetuese. Një qasje e tillë jo vetëm që e zhvendos përgjegjësinë nga Kuvendi si institucion, por gjithashtu krijon precedent problematik në raport me respektimin dhe zbatimin e rendit kushtetues.

Rekomandim: Deputetët e Kuvendit të Kosovës duhet të ruajnë standarde të larta të etikës dhe profesionalizmit gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, veçanërisht në procese me rëndësi kushtetuese. Sjelljet dhe komunikimet që mund të perceptohen si joserioze apo denigruese për institucionet duhet të shmangen, në mënyrë që të ruhet besimi i publikut në institucionet demokratike.

Tentativa për shmangien e procedurave për Projektligjin për Byronë

Shumica parlamentare, Lëvizja Vetëvendosje, propozoi që të shmanget procedura e rregullt për shqyrtimin e Projektligjit për Byronë, përkundër thirrjeve të deputetëve të opozitës si dhe të Instituti i Kosovës për Drejtësi që i njëjti të trajtohet në procedurë të rregullt për shkak të rëndësisë dhe ndjeshmërisë së tij.

[16] KOHA.net. “Bardiqi kërkon falje për ‘karatenë’, e quan sarkazëm.” KOHA.net, 28 prill 2026. Link: <https://www.koha.net/arberi/bardiqi-kerkon-falje-per-karaten-e-quan-sarkazem>. Qasur për herë të fundit më: 06.05.2026.

Projektligji, i cili më herët është rrëzuar dy herë nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, kërkon shqyrtim të kujdesshëm dhe adresim të plotë të çështjeve në mes të dy leximeve. Megjithatë, propozimi për shmangien e procedurave nuk është miratuar, pasi nuk ka arritur të sigurojë shumicën prej dy të tretave (2/3) të deputetëve të pranishëm dhe pjesëmarrës në votim.

Tentativa për të shmangur procedurat për një projektligj të kësaj rëndësie paraqet rrezik për cilësinë e legjislacionit dhe përputhshmërinë e tij me Kushtetutën, duke marrë parasysh natyrën e ndjeshme të këtij ligji dhe implikimet e tij në të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit.

Rekomandim: Kuvendi i Kosovës duhet të shmangë çdo praktikë të anashkalimit të procedurave për projektligje, sidomos projektligjet me rëndësi të veçantë dhe të sigurojë trajtim të rregullt, transparent dhe gjithëpërfshirës të tyre.

Projektligji për Byronë u procedua me nguti për dëgjim publik, pavarësisht refuzimit për shmangien e procedurave

Përkundër faktit se propozimi për shmangien e procedurave të rregullta parlamentare për Projektligjin për Byronë nuk është miratuar në seancë plenare, procesi i mëtejshëm i shqyrtimit është zhvilluar me nguti dhe në kundërshtim me standardet e konsultimit publik. Komisioni për Legjislacion ka organizuar dëgjimin publik për këtë projektligj duke publikuar ftesën më pak se 24 orë para mbajtjes së tij, duke pamundësuar pjesëmarrje reale dhe kontribut përmbajtësor nga akterët relevantë.

Kjo qasje bie ndesh me Rregulloren e Kuvendit të Kosovës, e cila kërkon që ftesa për dëgjim publik të publikohet së paku pesë (5) ditë më herët. Për më tepër, duke pasur parasysh se ky projektligj është rrëzuar dy herë nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës dhe se trajtohet për herë të tretë, procedimi me nguti cenon cilësinë e legjislacionit dhe besueshmërinë e procesit.

Në këto rrethana, edhe pse nuk është lejuar shmangia formale e procedurave, mënyra e zhvillimit të procesit reflekton një tendencë për procedim të përshpejtuar dhe konsultime formale, pa përmbajtje reale.

Rekomandim: Kuvendi i Kosovës duhet të sigurojë që projektligjet me rëndësi të veçantë të trajtohen pa nguti dhe në përputhje me afatet dhe standardet e konsultimit publik, duke garantuar pjesëmarrje reale dhe kontribut substancial të akterëve relevantë në procesin legjislativ.

Miratimi i vonuar dhe jo-transparent i Planit të Punës për sesionin pranveror 2026

Kuvendi i Kosovës miratoi me vonesë Planin e Punës për sesionin pranveror 2026, ndonëse sipas Rregullores së Kuvendit të Kosovës, Kryesia e Kuvendit në bashkëpunim me kryetarët e grupeve parlamentare ka për detyrë planifikimin e punës së Kuvendit. Kuvendi është konstituar më 11 shkurt 2026, ndërsa plani i punës është miratuar vetëm pas përfundimit të masës së përkohshme të vendosur nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, e cila masë përfundoi gjatë muajit mars 2026.

[16] KOHA.net. "Bardiqi kërkon falje për 'karatenë', e quan sarkazëm." KOHA.net, 28 prill 2026. Link: <https://www.koha.net/arberi/bardiqi-kerkon-falje-per-karaten-e-quan-sarkazem>. Qasur për herë të fundit më: 06.05.2026.

Për më tepër, miratimi i këtij plani është bërë pa publikimin paraprak të draftit dhe pa konsultime me shoqërinë civile apo grupet e interesit. Gjithashtu, janë evidentuar mangësi teknike, përfshirë përfshirjen në plan të projektligjeve që tashmë janë miratuar, si dhe pasaktësi në planifikimin e projektligjeve për periudhën maj–korrik 2026. Në mungesë të publikimit paraprak të draftit, Instituti i Kosovës për Drejtësi dhe akterët tjerë nuk kanë pasur mundësi të japin komente apo të identifikojnë mangësi të tjera.

Rekomandim: Kryesia e Kuvendit duhet të sigurojë miratimin me kohë të Planit të Punës për çdo sesion, përmes një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës, duke përfshirë publikimin paraprak të draftit dhe konsultimin me shoqërinë civile dhe grupet e interesit, në mënyrë që të garantohet planifikim dhe cilësi më e mirë e punës parlamentare.

Shkeljet ligjore në anulimin e procesit të zgjedhjes së Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit

Kryesia e Kuvendit ka dështuar të përmbyllë procesin e përzgjedhjes së Sekretarit të Përgjithshëm, ndonëse të gjitha procedurat ligjore janë përfunduar dhe dy kandidatët kanë përbushur kriteret për emërim. Në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit të Kosovës dhe Ligjin për Zyrtarët Publik, Kryesia nuk ka votuar asnjërin nga kandidatët e propozuar dhe ka iniciuar shpalljen e një konkursi të ri pa bazë ligjore.[17]

Procesi i rekrutimit, i filluar në gusht 2024, është zhvilluar në përputhje me procedurat ligjore, pa ankesa dhe pa kontestime, dhe është përmbyllur me dorëzimin e raportit përfundimtar për vendimmarrje në dhjetor 2024. Pavarësisht kësaj, Kryesia në Legjislaturën e VIII-të nuk ka vepruar brenda afateve ligjore për përzgjedhjen e njërit nga kandidatët, duke tejkaluar afatin e përcaktuar dhe duke lënë pozitën pa emërim të rregullt.

Mosveprimi i Kryesisë në Legjislaturën e X-të dhe tentativa për anulimin e një procesi të përfunduar përbën vendimmarrje arbitrare, cenon sigurinë juridike të kandidatëve dhe krijon precedent të rrezikshëm për anashkalimin e procedurave ligjore në institucionet publike

Rekomandim: Kryesia e ardhshme e Kuvendit duhet të përfundojë menjëherë procesin e përzgjedhjes së Sekretarit të Përgjithshëm, duke emëruar njërin nga kandidatët e propozuar në përputhje me ligjin, dhe të shmangë praktikën që cenojnë sigurinë juridike dhe integritetin e administratës publike.

Shumica parlamentare dështoi mbledhjen e Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi, Tregti dhe Inovacion

Deputetët e Lëvizja VETËVENDOSJE! nuk morën pjesë në mbledhjen e këtij komisioni, në të cilën pikë e vetme e rendit të ditës ishte raportimi i Bordit të ZRRE lidhur me vendimin për tarifën e energjisë elektrike, bilancin për vitin 2026, shitblerjen e energjisë elektrike dhe çështje të tjera.[18]

[17] Neni 19, Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës; nenet 47 dhe 49, Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 05 janar 2023.

[18] KOHA.net. "Dështon mbledhja e Komisionit për Ekonomi, do të raportonte Bordi i ZRRE-së." KOHA.net, 3 prill 2026. Link: <https://www.koha.net/arberi/deshton-mbledhja-e-komisionit-per-ekonomi-do-te-raportonte-bordi-i-zrre-se>. Qasur për herë të fundit më: 06.05.2026.

Duke qenë se, sipas Rregullores së Kuvendit, kuorumi për fillimin dhe mbajtjen e mbledhjes është 50% + 1 e anëtarëve të komisionit, mungesa e deputetëve të shumicës parlamentare bëri që mbledhja të mos mund të mbahej.

Në këtë rast, Lëvizja VETËVENDOSJE! nuk dha asnjë arsytim për mospjesëmarrjen, duke pamundësuar shqyrtimin e një teme me interes të lartë publik që lidhet drejtpërdrejt me tarifën e energjisë elektrike dhe ndikimin e tyre tek qytetarët dhe bizneset.

Rekomandim: Grupet parlamentare duhet të adresojnë mungesën e pjesëmarrjes së deputetëve në mbledhjet e komisioneve, duke diskutuar brenda grupeve përkatëse dhe duke kërkuar nga deputetët të marrin pjesë rregullisht, në mënyrë që të sigurohet kuorumi, të garantohet ushtrimi efektiv i funksionit mbikëqyrës dhe trajtimi i çështjeve me interes publik.

Mosadresimi i kërkesës për debat parlamentar lidhur me moszbatimin e ligjit për pensionin e dyfishtë

IKD, më 19 shkurt 2026 dorëzoi kërkesën për inicimin e një debati parlamentar lidhur me moszbatimin e legjislacionit në fuqi për realizimin e të drejtës në pensionin e moshës krahas pensionit për kategoritë e dala nga lufta. Përkundër kësaj kërkesë, deri në përfundim të mandatit të Kuvendit nuk është ofruar asnjë përgjigje nga Kryetarja e Kuvendit, nënkryetarët apo kryetarët e grupeve parlamentare.[19]

Mosadresimi i kësaj kërkesë ka pamundësuar ushtrimin e funksionit mbikëqyrës të Kuvendit ndaj një çështjeje që lidhet me moszbatimin e ligjit dhe me të drejtat sociale të qytetarëve. Kjo çështje ka prodhuar pasoja të vazhdueshme juridike dhe financiare, përfshirë ngarkesë të lartë të gjykatave dhe kosto shtesë për buxhetin e shtetit, si rezultat i praktikës së vazhdueshme të refuzimit të kësaj të drejte nga institucionet përgjegjëse.

Rekomandim: Kuvendi i Kosovës duhet të trajtojë në kohë kërkesat për debat parlamentar që lidhen me moszbatimin e ligjit dhe të drejtat e qytetarëve, duke iniciuar diskutime dhe mekanizma mbikëqyrës, në mënyrë që të sigurohet zbatimi i legjislacionit në fuqi dhe trajtimi i çështjeve me interes publik.

Braktisja e amendamenteve për buxhetin nga PDK

Në seancën plenare për "Shqyrtimin e dytë të Projektligjit nr. 10/L-001 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2026", Grupi Parlamentar i PDK-së i tërhoqi gjitha amendamentet e propozuara, duke u arsyetuar se ato nuk kanë kaluar në Komision për Buxhet. Kjo tërheqje është bërë pa ofruar ndonjë arsytim substancial apo sqarim për përmbajtjen dhe qëllimin e amendamenteve të paraqitura më herët.[20]

[19] Instituti i Kosovës për Drejtësi. "IKD kërkon debat parlamentar për moszbatimin e ligjit dhe mosrealizimin e të drejtës për pension të dyfishtë." Instituti i Kosovës për Drejtësi, 19 shkurt 2026. Link: <https://kli-ks.org/ikd-kerkon-debat-parlamentar-per-moszbatimin-e-ligjit-dhe-mosrealizimin-e-te-drejte-per-pension-te-dyfishte/>. Qasur për herë të fundit më: 05.05.2026.

[20] Seanca Plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 20 shkurt 2026. https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2026_02_20_ts_Seanca_NPhc2K6Be3.pdf. (qasur më: 6 maj 2026).

Ndryshe nga kjo qasje, grupet tjera opozitare, si LDK dhe AAK, pavarësisht se amendamentet e tyre nuk kanë kaluar në komision, i kanë paraqitur dhe diskutuar ato në seancë plenare, duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe informimin e qytetarëve për propozime dhe qëndrimet e tyre politike.

Tërheqja e amendamenteve pa arsyetim nga ana e PDK-së nuk përputhet me një rol aktiv opozitar. Duke qenë se shqyrtimi i amendamenteve në komisione zhvillohet pa praninë e publikut, mungesa e prezantimit të tyre në seancë plenare i privon qytetarët nga mundësia për të kuptuar alternativat dhe propozimet konkrete për një ligj me rëndësi të lartë si buxheti i shtetit.

Rekomandim: Grupet parlamentare, veçanërisht ato opozitare, duhet të sigurojnë që amendamentet e propozuara të prezantohen dhe diskutohen në seancë plenare, pavarësisht rezultatit në komisione, në mënyrë që të garantohet transparencë, informim i qytetarëve dhe ushtrim efektiv i rolit mbikëqyrës në procesin legjislativ.

Refuzimi i amendamenteve të opozitës nga shumica parlamentare në Buxhetin 2026

Në seancën plenare për shqyrtimin e dytë të Projektligjit nr. 10/L-001 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2026, amendamentet e propozuara nga grupet parlamentare të LDK-së dhe AAK-së nuk kanë marrë mbështetjen e shumicës parlamentare dhe, rrjedhimisht, nuk janë miratuar. [21]

Ndryshe nga rasti i PDK-së, këto amendamente janë paraqitur dhe diskutuar në seancë plenare, duke ofruar transparencë dhe duke mundësuar që qytetarët të informohen për alternativat dhe propozimet konkrete të opozitës. Megjithatë, refuzimi i të gjitha amendamenteve të opozitës nga ana e shumicës parlamentare tregon mungesë të një qasjeje përmbytësore dhe gjithëpërfshirëse në trajtimin e tyre.

Një praktikë e tillë e redukton procesin legjislativ në një votim formal, pa reflektuar mbi përmbytjen e propozimeve dhe pa marrë parasysh që opozita përfaqëson një pjesë të rëndësishme të qytetarëve. Kjo dobëson funksionin e Kuvendit si hapësirë e debatit pluralist dhe kufizon rolin mbikëqyrës të opozitës.

Rekomandim: Shumica parlamentare duhet të trajtojë amendamentet e opozitës në mënyrë përmbytësore, duke vlerësuar meritat e tyre dhe duke reflektuar një qasje më gjithëpërfshirëse në procesin legjislativ.

Mosmiratimi i amendamentit për zbatimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në Ligjin për Buxhetin 2026

Gjatë shqyrtimit të Projektligjit mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2026, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka kërkuar nga deputetët e Kuvendit që përmes amendamenteve të adresojnë shkeljen e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese e Kosovës lidhur me pagesën e përvojës së punës për zyrtarët publikë.

[21] Seanca Plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 20 shkurt 2026. https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2026_02_20_ts_Seanca_NPhc2K6Be3.pdf. (qasur më: 6 maj 2026).

Një deputet mori përsipër hartimin dhe paraqitjen e amendamentit, i cili synonte harmonizimin e projektligjit me aktgjykimin KO79/23.[22]

Megjithatë, ky amendament nuk është miratuar, pasi është votuar kundër nga shumica parlamentare. Si rezultat, në Ligjin për Buxhetin për vitin 2026 është përfshirë një dispozitë që nuk respekton afatin e përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese për zbatimin e pagesës nga data 1 shkurt 2024, duke e shtyrë atë për vitin 2026.

Mosmiratimi i këtij amendamenti ka rezultuar në vazhdimin e një situatë të moszbatimit të aktgjyimit kushtetues, duke prodhuar pasoja financiare për mijëra zyrtarë publikë dhe duke rritur rrezikun për ngarkesë shtesë të sistemit gjyqësor përmes padive individuale.

Rekomandim: Kuvendi i Kosovës duhet të sigurojë që gjatë shqyrtimit të projektligjeve, veçanërisht atyre me implikime financiare, të respektohen aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese, duke mbështetur amendamentet që synojnë harmonizimin e legjislacionit me Kushtetutën dhe duke parandaluar miratimin e dispozitave që cenojnë të drejtat e punëtorëve të administratës shtetërore.

Përzgjedhja e anëtarëve të bordeve të RTK-së dhe KPM-së në procese të komprometuara

Procesi për përzgjedhjen e anëtarëve të bordit të Radio Televizionit të Kosovës (RTK) dhe të Komisionit të Pavarur për Media (KPM) është zhvilluar me mangësi serioze në transparencë dhe rregullsi procedurale, duke cenuar parimin e meritokracisë. Procesi është karakterizuar nga nxitim në zhvillimin e procesit, mungesë kohe të mjaftueshme për vlerësim të drejtë dhe organizim jo të rregullt të procedurave.

Gjithashtu, janë evidentuar probleme në trajtimin e barabartë të kandidatëve dhe në metodologjinë e vlerësimit, përfshirë mungesën e një sistemi të qartë dhe transparent të poentimit gjatë intervistimit. Këto mangësi kanë krijuar hapësirë për ndikim politik dhe kanë cenuar besueshmërinë e procesit.

Si rezultat, përzgjedhja e anëtarëve të këtyre bordeve është bërë në një proces të komprometuar, duke ngritur shqetësime për pavarësinë dhe integritetin e këtyre institucioneve të rëndësishme publike. [22]

Rekomandim: Kuvendi i Kosovës duhet të sigurojë që proceset e përzgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të pavarura të zhvillohen në mënyrë transparente, të rregullt dhe të bazuar në meritë, duke garantuar trajtim të barabartë të kandidatëve dhe shmangie të çdo ndikimi politik në këto procese.

Ndryshimi i kundërligjshëm i përbërjes së Komisionit për Provimin e Jurisprudencës

Qeveria e Kosovës, përgjatë kësaj periudhe të monitorimit mori vendim për ndryshimin e përbërjes së Komisionit për dhënien e Provimit të Jurisprudencës, ndonëse anëtarët e këtij komisioni kanë mandat aktiv deri në fund të vitit 2026. Ligji Nr. 08/L-033 për Provimin e Jurisp-

[23] Instituti i Kosovës për Drejtësi. "Anëtarët e bordeve të RTK-së dhe KPM-së zgjidhen në procese të komprometuara." Instituti i Kosovës për Drejtësi, 24 prill 2026. Link: <https://kli-ks.org/anetaret-e-bordevete-rtk-se-dhe-kpm-se-zgjidhen-ne-procese-te-komprometuara/>. Qasur për herë të fundit më: 01.05.2026

-rudencës, ndonëse anëtarët e këtij komisioni kanë mandat aktiv deri në fund të vitit 2026. Ligji Nr. 08/L-033 për Provimin e Jurisprudencës, në asnjë dispozitë të tij, nuk i jep autorizim Qeverisë që të ndryshojë përbërjen e këtij Komisioni gjatë kohëzgjatjes së mandatit të anëtarëve të tij.[24] Ky veprim është ndërmarrë pa bazë ligjore, pasi Ligji për Provimin e Jurisprudencës nuk parashikon mundësinë e ndërprerjes së mandatit të anëtarëve gjatë kohëzgjatjes së tij, duke e bërë vendimi arbitrar dhe në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë dhe sigurisë juridike. Këtë vendim të kundërligjshëm të Qeverisë, më pas e miratoi Kuvendi. Ky zhvillim shoqërohet edhe me mungesë të menaxhimit të rregullt të procesit nga ana e institucioneve përgjegjëse, duke marrë parasysh se nuk janë shpallur afatet për dhënien e provimit që nga prilli i vitit 2025. Në këto rrethana, ndryshimi i përbërjes së Komisionit ngre dyshime për ndërhyrje në funksionimin e tij.

Rekomandim: Kuvendi i Kosovës nuk duhet të miratojë vendime që bien në kundërshtim me ligjin dhe që cenojnë sigurinë juridike, ndërsa institucionet përgjegjëse duhet të respektojnë mandatin ligjor të organeve ekzistuese dhe të shmangin ndërhyrjet arbitrare në përbërjen e tyre.

Inicimi i nismës legjislative qytetare për ndryshimin e Kodit Penal

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës njoftimin për fillimin e nismës legjislative qytetare për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal, në mbështetje të nenit 79 të Kushtetutës dhe Ligjit për Nisma Legjislative. Nisma synon adresimin e dy çështjeve kryesore: kriminalizimin e moszbatimit të vendimeve të Gjykata Kushtetuese e Kosovës dhe kriminalizimin e keqpërdorimit të parasë publike për përfitim elektoral.[25]

Përmes kësaj nisme synohet mbyllja e boshllëqeve ligjore që mundësojnë shmangien e përgjegjësisë për moszbatimin e vendimeve kushtetuese, si dhe parandalimi i praktikave që cenojnë integritetin e proceseve zgjedhore përmes përdorimit të burimeve publike. Në vijim të këtij procesi, parashihet mobilizimi i qytetarëve për mbledhjen e nënshkrimeve dhe përfshirja e grupeve të interesit në këtë iniciativë.

Rekomandim: Pas dorëzimit të nismës legjislative qytetare në Kuvend, Kryesia e Kuvendit duhet ta trajtojë atë me prioritet dhe në përputhje me afatet ligjore, duke siguruar një shqyrtim efektiv dhe gjithëpërfshirës të saj.

Mungesë e përgjegjësisë së deputetëve në pas parashtrimit të pyetjeve parlamentare

Në seancën e 20 shkurtit 2026, disa deputetë që kishin parashtruar pyetje parlamentare nuk kanë qenë të pranishëm në sallë, përfshirë deputetin Eman Rrahmani dhe deputeten Ganimete Musliu.[26]

Duke qenë se deputetët janë të njoftuar paraprakisht për rendin e ditës dhe për pyetjet që vetë i kanë parashtruar, mungesa e tyre në seancë e dobëson seriozitetin e këtij mekanizmi dhe kufizon mundësinë për ushtrim efektiv të rolit mbikëqyrës ndaj ekzekutivit.

[26] Seanca plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 20 shkurt 2026. Link: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2026_02_20_ts_Seanca_NPhc2K6Be3.pdf. (qasur për herë të fundit më: 01.05.2026)

Bartja e pyetjeve parlamentare si pasojë e mungesës së ministrave dhe koordinimit institucional

Nga të dhënat rezulton se një numër pyetjesh janë bartur nga një seancë në tjetrën (20 shkurt → 10 prill → 17 prill → 24 prill), kryesisht për shkak të mungesës së ministrave ose kërkesave të vetë deputetëve për shtyrje.

Në disa raste, bartja ka ndodhur sepse ministrat përkatës nuk kanë qenë të pranishëm në seancë, ndërsa në raste të tjera deputetët kanë kërkuar vetë shtyrjen e pyetjeve. Kjo tregon se përgjegjësia për zvarritjen e këtij procesi është e ndarë ndërmjet legjislativit dhe ekzekutivit, si dhe reflekton mungesë të koordinimit efektiv institucional.

Mungesë e përkohshme e ministrave dhe përgjigje të shtyra në kohë

Në disa seanca, ministrat dhe në raste të caktuara edhe Kryeministri nuk kanë qenë të pranishëm për t'iu përgjigjur pyetjeve parlamentare. Megjithatë, në pjesën më të madhe të rasteve, është bërë e ditur se mungesa e tyre ka qenë e njoftuar paraprakisht tek kryesuesi apo Kryetarja e Kuvendit, zakonisht për shkak të angazhimeve zyrtare ose udhëtimeve jashtë vendit.

Në shumicën e këtyre rasteve, pyetjet janë shtyrë për seanca të ardhshme, ku ministrat kanë qenë të pranishëm dhe kanë dhënë përgjigje. Megjithatë, kjo praktikë ka ndikuar në vonimin e përgjigjeve dhe ka dobësuar funksionin e pyetjeve parlamentare si mekanizëm për llogaridhënie të menjëhershme.

Përdorimi i përgjigjeve me shkrim në mungesë të përgjigjeve në seancë

Në rastet kur ministrat apo Kryeministri nuk kanë qenë të pranishëm, deputetët kanë pranuar që përgjigjet të jepen me shkrim ose janë detyruar të presin deri në seancat e ardhshme. Kjo praktikë, ndonëse e lejuar, e redukton efektivitetin e pyetjeve parlamentare, pasi mungon debati i drejtpërdrejtë dhe mundësia për sqarime shtesë në kohë reale.

Mungesë e planifikimit dhe efikasitetit në zhvillimin e pyetjeve parlamentare

Analiza e disa seancave tregon mungesë të një planifikimi të qëndrueshëm në zhvillimin e pyetjeve parlamentare, duke përfshirë bartjen e shpeshtë të pyetjeve, mungesën e sinkronizimit mes deputetëve dhe ministrave dhe shtyrjet e vazhdueshme.

Kjo situatë e dobëson funksionin mbikëqyrës të Kuvendit dhe e kthen këtë mekanizëm në një proces më shumë formal sesa efektiv.

Rekomandim: Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria duhet të sigurojnë koordinim më të mirë për zhvillimin e pyetjeve parlamentare, duke garantuar praninë e rregullt të deputetëve dhe ministrave në seancë. Pyetjet parlamentare duhet të trajtohen me prioritet dhe në kohë reale, në mënyrë që të sigurohet llogaridhënie efektive dhe të shmangen vonesat e panevojshme në këtë mekanizëm mbikëqyrës.

Dominimi i seancave të jashtëzakonshme dhe kontrolli i agjendës nga shumica parlamentare

Gjatë periudhës shkurt–prill 2026, Kuvendi i Kosovës ka mbajtur gjithsej 24 seanca, të ndara si vijon:

- 10 seanca të jashtëzakonshme (41.7%)
- 7 seanca të rregullta (29.2%)
- 3 seanca solemne (12.5%)
- 3 seanca të veçanta (12.5%)
- 1 seancë konstituive (4.1%)

Nga gjithsej 10 seanca të jashtëzakonshme:

- 7 janë thirrur nga Lëvizja Vetëvendosje
- 1 nga LDK (Jehona Lushaku)
- 1 nga PDK (Arian Tahiri)
- 1 nga deputet individual – Ramush Haradinaj

Këto të dhëna tregojnë se shumica parlamentare ka pasur rol dominues në përcaktimin e agjendës së Kuvendit përmes përdorimit të seancave të jashtëzakonshme.

Për më tepër, fakti që mbi 40% e seancave janë zhvilluar si të jashtëzakonshme tregon një orientim të theksuar drejt vendimmarrjes jashtë planifikimit të rregullt parlamentar. Kjo praktikë e dobëson rolin e seancave të rregullta si hapësira kryesore për debat të strukturuar dhe rrit varësinë nga vendimmarrja ad hoc.

Në të njëjtën kohë, opozita (LDK dhe PDK) ka përdorur në mënyrë shumë të kufizuar këtë mekanizëm, duke reflektuar një ndikim më të vogël në përcaktimin e agjendës parlamentare krahasuar me shumicën.

Rekomandim: Kuvendi i Kosovës duhet të sigurojë një balancë më të madhe ndërmjet seancave të rregullta dhe atyre të jashtëzakonshme, duke kufizuar përdorimin e këtyre të fundit vetëm në raste të domosdoshme dhe duke garantuar një planifikim më të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të agjendës parlamentare.

Annex I: Aktiviteti total i deputetëve në Legjislaturën X

Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë detyrim kushtetues dhe politik që të jenë aktiv në përmbushjen e përgjegjësisë të tyre legjislative dhe përfaqësuese. Pjesëmarrja aktive në seanca plenare dhe kontributi përmes fjalimeve janë element kyç për funksionimin efektiv të Kuvendit dhe për adresimin e çështjeve me interes për qytetarët. Mungesa e angazhimit ose fokusimi i kufizuar në disa tema të caktuara ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e debatit parlamentar dhe në përfaqësimin e interesit publik.

Nga monitorimi i të gjitha fjalimeve të deputetëve në Legjislaturën X, rezulton se deputetët kanë mbajtur gjithsej 508 fjalime. Në vijim paraqiten fushat kryesore të trajtimit:

Tema/Çështja	Numri i deklaratave	%	Tema/Çështja	Numri i deklaratave	%
Ekonomi dhe Financa	161	31.7%	Arsim	9	1.8%
Drejtesia	60	11.8%	Punë të Jashtme	5	1%
Për procedurë	56	11%	Mjedisi	3	0.6%
Energji	55	10.8%	Dialogu Kosovë-Serbi	3	0.6%
Histori/Solemnitet/ Seancë e veçantë	37	7.3%	Qeverisje komunale	3	0.6%
Mirëqenia Sociale	24	4.7%	Të drejtat e komuniteteve	2	0.4%
Shëndetësi	21	4.1%	Integrime Evropiane	1	0.2%
Infrastrukturë	16	3.1%	Bujqësi	1	0.2%
Siguri	15	3%	Liria e Medias	1	0.2%
Kulturë dhe Sport	14	2.8%			
Administratë publike	12	2.4%			
Zgjedhja e organeve kolegjiale	9	1.8%			

Tabela nr. 1 - Numri i deklaratave të deputetëve në bazë të 21 temave të ngritura gjatë aktivitetit në seancat plenare të Kuvendit

Shpërndarja e fjalimeve të deputetëve tregon një përqendrim të theksuar në disa fusha të caktuara. Temat e ekonomisë dhe financave përbëjnë mbi 31% të të gjitha fjalimeve, duke e bërë këtë fushë dominuesen në debatet parlamentare.

Një pjesë e konsiderueshme e fjalimeve, rreth 11%, i përket çështjeve procedurale. Kjo tregon se një segment i rëndësishëm i kohës parlamentare është shpenzuar në çështje teknike, në vend të trajtimit përmbajtësor të politikave publike.

Në të njëjtën kohë, disa fusha me rëndësi të lartë publike janë trajtuar në mënyrë shumë të kufizuar. Dialogu Kosovë-Serbi dhe mjedisi përbëjnë vetëm nga 0.6% të fjalimeve, integrimet evropiane 0.2%, ndërsa të drejtat e komuniteteve 0.4%. Po ashtu, mungon plotësisht trajtimi i disa temave, përfshirë çështjet gjinore, diasporën dhe efikasitetin në qeverisje, për të cilat nuk është evidentuar asnjë fjalim.


Rekomandim: Deputetët e Kuvendit të Kosovës duhet të sigurojnë një shpërndarje më të balancuar të angazhimit të tyre në debat parlamentar, duke trajtuar në mënyrë më të qëndrueshme të gjitha fushat me interes publik. Është e nevojshme rritja e fokusit në tema që aktualisht janë të nënpërfaqësuar, në mënyrë që debati parlamentar të reflektojë në mënyrë më gjithëpërfshirëse prioritetet e shoqërisë.

Aktiviteti i deputetëve sipas grupeve parlamentare

Nga analiza e deklarimeve të deputetëve gjatë vitit 2026 rezulton se grupi parlamentar i Partia Demokratike e Kosovës ka numrin më të madh të deklaratave (145), i ndjekur nga Lëvizja Vetëvendosje (135) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (121). Ndërkohë, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka 58 deklaratave, ndërsa grupi MULTIETNIK vetëm 23 dhe Lista Serbe 15 deklaratave. Deputetët pa grup parlamentar nuk kanë dhënë asnjë deklaratë

Nga të dhënat rezulton se grupi parlamentar i PDK-së ka numrin më të madh të deklaratave, ndërsa Lëvizja Vetëvendosje, si pjesë e shumicës qeverisëse, renditet e dyta. LDK renditet pas LV-së, ndërsa grupet e tjera kanë një nivel dukshëm më të ulët të deklarimeve.

Në të njëjtën kohë, niveli i ulët i deklarimeve nga grupi MULTIETNIK dhe Lista Serbe, si dhe mungesa e plotë e angazhimit nga deputetët pa grup parlamentar, tregon për një pjesëmarrje të kufizuar në debat parlamentar dhe përfaqësim të dobët të çështjeve që lidhen me këto grupe.



Treguesi nr. 2 - Numri total i deklaratave në bazë të grupeve parlamentare

Mungesa e plotë e angazhimit të një pjese të deputetëve në debat parlamentar

Në bazë të të dhënave rezulton se 26 deputetë të Kuvendit të Kosovës nuk kanë mbajtur asnjë deklaratë në seancë plenare gjatë periudhës së monitoruar në Legjislaturën X, nga gjithsej 508 deklaratave të evidentuara.

Këta deputetë kryesisht i përkasin grupeve parlamentare më të vogla dhe Listës Serbe, ndërsa në disa raste përfshihen edhe deputetë të tjerë me nivel shumë të ulët të angazhimit.

Mungesa e plotë e deklarimeve nga këta deputetë tregon një nivel të ulët të ushtrimit të funksionit përfaqësues dhe mbikëqyrës në Kuvend. Duke qenë se pjesëmarrja në debat parlamentar është një nga mekanizmat kryesorë për përfaqësimin e qytetarëve dhe për kontrollin e ekzekutivit, mosangazhimi në këtë aspekt e dobëson funksionimin e Kuvendit si institucion demokratik.

Në të njëjtën kohë, duhet marrë parasysh se një pjesë e deputetëve mund të mos kenë përfunduar mandatin e plotë për shkak të rrethanave të ndryshme politike apo institucionale, çka mund të ketë ndikuar në nivelin e tyre të angazhimit.

Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave	Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave
1	Besnik Tahiri	AAK	30	16	Përparim Gruda	PDK	9
2	Arbërie Nagavci	LV	25	17	Emilja Redzeqi	MULTIETNIK	9
3	Hykmete Bajrami	LDK	22	18	Erxhan Galushi	MULTIETNIK	8
4	Jehona Lushaku Sadriu	LDK	19	19	Ferat Shala	PDK	8
5	Bedri Hamza	PDK	16	20	Blerta Deliu Kodra	PDK	8
6	Ganimete Musliu	PDK	15	21	Adelina Thaçi Meta	LDK	7
7	Armend Zemaj	LDK	14	22	Albana Bytyqi	AAK	7
8	Albulena Haxhiu	LV	13	23	Besian Mustafa	LDK	7
9	Arian Tahiri	PDK	13	24	Eman Rrahmani	PDK	7
10	Ariana Musliu Shoshi	PDK	12	25	Lumir Abdixhiku	LDK	7
11	Arbnore Saliu	PDK	11	26	Mefail Bajqinovci	LV	7
12	Artan Asllani	MULTIETNIK	11	27	Arben Mustafa	PDK	6
13	Avdullah Hoti	LDK	10	28	Besa Kabashi Ramaj	PDK	6
14	Janina Ymeri	LDK	10	29	Ermal Sadiku	LDK	6
15	Time Kadrijaj	AAK	10	30	Slavko Simic	LS	6
Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave	Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave
31	Uran Ismaili	PDK	6	46	Enver Hoxhaj	PDK	4
32	Arjeta Fejza	LV	5	47	Fadil Hadergjonaj	LDK	4
33	Artan Behrami	PDK	5	48	Igor Simic	LS	4
34	Ejup Ahmeti	LV	5	49	Ramush Haradinaj	AAK	4
35	Ilir Kërçeli	LV	5	50	Adnan Rrustemi	LV	3
36	Lutfi Haziri	LDK	5	51	Albena Reshitaj	LV	3
37	Rozeta Hajdari	LV	5	52	Anton Quni	LDK	3
38	Vigan Qorrolli	LV	5	53	Arijeta Rexhepi	LV	3
39	Vlora Çitaku	PDK	5	54	Bajram Mavriqi	LV	3
40	Arbëreshë Kryeziu-Hyseni	LV	4	55	Bekë Berisha	AAK	3
41	Artan Abrashi	LV	4	56	Driton Hyseni	LV	3
42	Daut Haradinaj	AAK	4	57	Egzon Azemi	LV	3
43	Daorsa Kica Xhelili	LDK	4	58	Haxhi Avdyli	LV	3
44	Enver Dugolli	LV	4	59	Jeta Statovci	LV	3
45	Enver Haliti	LV	4	60	Kujtim Gashi	PDK	3
Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave	Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave
61	Liza Gashi	LV	3	76	Fatos Geci	LV	1
62	Mërgim Lushtaku	PDK	3	77	Fjolla Ujkani	LV	1
63	Sala Jashari	PDK	3	78	Ilir Qeriqi	LV	1
64	Valon Hoti	LV	3	79	Labinotë Demi Murtezi	LV	1
65	Veton Berisha	MULTIETNIK	3	80	Liljana Stefanovic	LS	1
66	Ardian Gola	LV	2	81	Miljana Nikolic	LS	1
67	Arsim Ademi	LV	2	82	Mytaher Haskuka	LV	1
68	Bylbyl Sokoli	LV	2	83	Nemanja Bisevac	LS	1
69	Nait Hasani	PDK	2	84	Rrahman Rama	PDK	1
70	Ergul Mazrek	MULTIETNIK	2	85	Rufki Suma	LV	1
71	Kujtim Shala	LDK	2	86	Shqipe Isufi	LV	1
72	Avdullah Klinaku	LV	1	87	Shqipe Mehmeti Selimi	LV	1
73	Avni Dehari	LV	1	88	Srdjan Popovic	LS	1
74	Elmi Reçica	PDK	1	89	Ukë Rugova	LDK	1
75	Fatma Taçi	MULTIETNIK	1	90	Verica Ceranic	LS	1

Tabelat 2-7 - Numri i deklaratave të deputetëve në të gjithë aktivitetin e Kuvendit për legjislaturën e X-të

Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave	Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave
91	Xhavit Haliti	PDK	1	106	Edona Lialloshi	LV	0
92	Alban Bajrami	LV	1	107	Fahrush Rexhepi	LV	6
93	Fatmire Kollqaku	LV	1	108	Fitim Haziri	LV	0
94	Luan Aliu	LV	1	109	Fridon Lala	MULTIETNIK	0
95	Adelina Granica	LV	0	110	Hysen Durmishi	LV	0
96	Adem Hodza	PG	0	111	Jeton Raka	LV	0
97	Adriana Matoshi	LV	0	112	Lazar Radulovic	MULTIETNIK	0
98	Afërdita Hajrizi	LV	0	113	Milan Kostic	LS	0
99	Agim Bahtiri	LV	0	114	Mimoza Shala	LV	0
100	Arbër Rexhaj	LV	0	115	Naim Bardiqi	LV	0
101	Bahrim Sabani	MULTIETNIK	0	116	Nezir Kraki	LV	0
102	Blerim Gashi	LV	0	117	Salih Zyba	LV	0
103	Branislav Nikolic	LS	0	118	Sylejman Mehollli	LV	0
104	Drita Pajaziti	LV	0	119	Taulant Kelmendi	LV	0
105	Duda Balje	PG	0	120	Valon Ramadani	LV	0

Tabelat 7-8 - Numri i deklaratave të deputetëve në të gjithë aktivitetin e Kuvendit për legjislaturën e X-të

Annex 2: Kuvendi në numra

Më 22 mars 2021, u konstitua Kuvendi i Kosovës pas zgjedhjeve parlamentare të mbajtura në shkurt të po këtij viti. Në po të njëjtën seancë, Kuvendi zgjodhi për Kryetar të Kuvendit, Glauk Konjufcën, nga partia më e madhe parlamentare si dhe u zgjodh Qeveria e Kosovës, në krye të së cilës ishte votuar Kryeministri Albin Kurti.

Gjatë kësaj legjislature, ishte një deputete nga ana e GP të PDK-së, Adelina Grainca e cila kaloi në GP të LVV-së, dhe një deputete nga LVV, Doarsa Kica Xhelili, që kaloi në GP të LDK-së.

Dy deputetë të GP të LVV-së, Fatmir Humolli dhe Haki Abazi, dhanë dorëheqje nga ky grup por duke qëndruar në kuvend si deputetë të pavarur. Bazuar në rezultatin dhe zgjedhor dhe ndryshimet e bëra, në fund të Legjislaturës së VIII-të, përbërja e grupeve parlamentare të konfirmuara ishte si në vijim:

Grupi parlamentar	Numri i deputetëve më 11 shkurt 2026	Numri i deputetëve më 28 prill 2026
Lëvizja VETËVENDOSJE!	57	57
Partia Demokratike e Kosovës	22	22
Lidhja Demokratike e Kosovës	15	15
Multietnik	9	9
Lista Serbe	9	9
Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës	6	6
Pa grup parlamentar	2	2

Tabela nr. 9 - Përbërja e grupeve parlamentare

Raporti **"Monitoruesi i Legjislaturës së X-të"** është realizuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi me mbështetjen e Rockefeller Brothers Fund.



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde



Rockefeller
Brothers Fund
Philanthropy for an Interdependent World